



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 22/05/2026 Ora : 12 / :00 Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 15 banorë

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

**PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TE VEPRIMIT PER BARAZI, PERFSHIRJE
DHE PJESMARRJEN E ROMEVE DHE EGJIPTJANEVE NE BASHKINE POGRADEÇ
(2026 – 2030)**

Pjesëmarrës :

Manjola Kamolli (Kryetare e Këshillit Bashkiak)

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Suela Mertkola (Punonjësë Sekretarjati)

Znj. Kryetare: Përshëndetje të gjithëve, ju falenderoj për pjesmarrjen tuaj. Besoj se kemi bërë shumë punë. Duhet të diskutojmë, për ne është shumë e rëndësishme mënyra si do hartohet plani, jam shumë e sigurtë që nga e gjithë stafi do bëhet një punë e shkëlqyer.

Znj.I.L.Lakmani : Ju faleminderit që ju përgjigjët. Dua t'ju sqaroj se çfarë është ky plan. Sot do të prezantohet plani 5-vjeçar. Prej disa vitesh ka munguar një strategji. Janë rreth 588 familje dhe rreth 1080 fiks banorë. Ky plan ka qëllim të qarta të garantojë barazinë. Plani fokusohet në disa pika kryesore. Ku një ndër pikat kryesore është Arsimi, sfidat janë të dukshme sepse kjo ndikon drejtpërdrejt në të ardhmen e tyre. Ne kemi 210 familje ku janë pjesë e skemë ekonomike. Një element i rëndësishëm është bashkëpunimi. Organizatat dhe bashkia duhet të punojnë së bashku. Ky plan nuk është thjesht një dokument strategjik. Ky është një dokument i përgjithshëm, mbi të

cilin ju mund të diskutoni dhe të shprehni mendimet edhe kërkesat tuaja, aplikuar për ta bashkërenditur.

Znj. Erjona: Faleminderit për pjesëmarrjen, në lidhje me aktivitetet ne kemi zhvilluar shumë aktivitete dhe do mundohemi akoma më shumë. Pjesa tjetër është diskriminimin nëpër shkolla. Rëndësia e shëndetit pjesa e vaksinimit nuk duhet të anashkalohej, duhet të vlerësohet. Në lidhje me punësimin mund të jepni edhe mendime. Kemi edhe kurse profesionale. Ju faleminderit.

Znj. Ivana: Ideja është që ky plan mos të mbetet vetëm në letër.

Banor 1: A është përfshirë në plan integrimi i familjeve nga emigrimi?

Znj. Ivana: Po, ne do të ofrojmë konsulencë për çdo nevojë.

Znj. Entela: Krahas planit që po diskutojmë, është edhe për ju që jeni kthyer nga emigracioni. Është një pyetje shumë e drejtë.

Znj. Ivana: Ne jemi munduar të ndihmojmë çdo emigrant, sidomos ata që kanë nevojë. Duhet të kemi parasysh edhe komunitetin rom dhe egjiptian për ne janë prioritet.

Znj. Manjola: Këtu janë përfshirë shumë aktivitete, përfshirë edhe strehimin social. Buxheti ka qenë i kufizuar.

Znj. Ivana: Në fakt, ky plan është shumë i vlefshëm. Buxheti është në funksion të një vlerësimi të përgjithshëm, sepse komunitetet tona janë pjesë e punës sonë.

Znj. Shuli: Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj. Kjo është një pjesëmarrje e gjerë dhe është e rëndësishme që ky plan të mos mbetet vetëm në letër. Duhet të jepni mendimet tuaja. Kemi edhe shoqata shumë aktive. E rëndësishme është arsimi dhe edukimi i fëmijëve tuaj.

Znj. Ivana: Për angazhimin tonë, prioritet do të jetë mirëarsimimi.

Banorja 1: Në këto kushte që jemi, kemi nevojë për banesa sociale dhe strehim.

Znj. Ivana: Duhet të ketë dëshirë edhe nga ana juaj për t'u afruar me punën. Në shumë raste nuk e gjejmë gatishmërinë tuaj për pjesën e punës.

Znj. Entela: Nuk duhet të mendoni vetëm për një përfitim monetar kur ju ofrohet një punë.

Banor: Për të rinjtë e lagjes që kanë mbaruar shkollën, a mund bashkia të ofrojë trajnime?

Znj. Elda: Ka një detyrim që ata që kanë mbaruar shkollën të ndjekin këtë strategji. Edhe një pjesë e atyre që e kanë kryer arsimin, ne kemi qenë gjithmonë të gatshëm t'i mbështesim.

Znj. Kamolli: Ka persona që kanë mbaruar studimet, por nuk njihen. Ata që kanë përfunduar studimet e larta nuk janë identifikuar.

Znj. Entela: Shkollat profesionale shërbejnë gjithmonë për të marrë një profesion. Sot, përveç diplomës, kërkohen edhe aftësi.

Banori 2: Shumë faleminderit. Unë dhe bashkëshortja ime kemi mbaruar vetëm 7 vite shkollë, jemi të dy të interesuar për të vazhduar më tej edhe më pas të mbarojmë edhe një shkollë profesionale.

Znj. Elda: Duhet të merrni një vërtetim nga shkolla ku keni studiuar, ne do jemi këtu për tju ndihmuar.

Znj. Entela: Do të kemi një vëmendje shumë të veçantë.

Banorja 4: Ne jemi përfitues të ndihmës ekonomike. Desha të pyes për rastin tonë, pasi nuk kemi banesë. A mund të na jepet një tokë me qira për ta ndërtuar?

Znj. Ivana: Duhet të kuptoni që nuk mund t'ju jepet çdo gjë menjëherë. Duhet edhe pak kohë për realizimin e këtyre qëllimeve. Gjithmonë do t'ju kemi në vëmendje.

Znj. Entela: Do të shohim edhe pjesën e bonusit të qirasë.

Znj. Elda: Zgjidhja është duke punuar dhe do të presim gjithmonë nga shteti. Po të filloni të punoni, me ofrimin që mund të merrni një shtëpi, duhet të synoni edhe shkollën. Duhet të fokusoheni edhe tek fëmijët.

Znj. Ivana: Kërkoni punë me sigurime dhe do ta garantoni jetën.

Znj. Manjola: Unë shpresoj që kemi një skuadër shumë të mirë. Ju falënderoj.

Protokolli : Suela Merfkola

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

